

“PETRELA GJATË SHEKUJVE”, LIBËR NË TRAJTËN E NJË MONOGRAFIE SHKENCORE¹

Petrela është një prej qendrave historike më të vjetra në Shqipëri. Është dëshmi e prekshme e identitetit, qëndresës, kulturës, historive dhe fakteve përgjatë shumë shekujve.

Si e tillë, Petrela është një ndër vendet tërheqëse kryesore në Tiranë, por dhe në Shqipëri, për sa i përket turizmit në përgjithësi dhe agroturizmit apo ekoturizmit në veçanti. Vlerë tjetër e kësaj zone janë dhe prodhimet artizanale, që do të thotë tradita shekullore vijon të jetë e trashëguar brez pas brezi për shumë produkte bujqësore, apo veshje dhe poçeri. E thënë kjo, hijeshisë së historisë që ajo mbart, i shtohet puna e shumë nënave dhe grave që lidhet me tjerren, qilimat, produkte të veçanta ushqimore që i gjen vetëm në Petrelë. Burrat merren më së shumti me prodhimin e poçeve, koshave që përdoren për vjeljen e rrushit, lëvrimin e tokave bujqësore, etj. Pra, kur shkon në Petrelë, vizitori gjen një copëz të artë nga e kaluara e ndërthurur me modernen dhe zhvillimin e përgjithshëm të zonës.

Mikpritja, si një virtyt i shqiptarëve, shprehet më së miri në këtë zonë. Nëse troket në derën e një banori të Petrelës, patjetër që do të trajtohesh në mënyrë shumë të veçantë.

Në vazhden e këtyre cilësive, Petrela meriton të dëshmohet, qoftë përmes kronikave të ndryshme, artikujve, emisioneve, po ashtu edhe përmes botimeve. Librat, sado që koha të përparojë, nuk e humbin asnjëherë vlerën dhe rëndësinë e tyre.

I tillë është dhe libri i dedikuar për Petrelën, që vjen në trajtën e një monografie shkencore me ngjyrimet emocionale të rrëfimit, të autorit Adem Kupi.

Autori kujdeset që, përgjatë shkrimit të këtij libri, të mos harrojë të nxjerrë në pah zhvillimin që Petrela ka pësuar ndër vite apo dekada. Në këtë mënyrë, lexuesi nuk shkëputet nga realiteti, por i përjeton të gjitha

1 Adem Kupi, Petrela gjatë shekujve, Tiranë: Onufri, 2023, 383 faqe.

gjendjet në një libër.

Pikë tjetër ku autori ndalet, si pjesë hyrëse apo njohëse me Petrelën, ka të bëjë me antikitetin e vonë, konkretisht me qytetin antik të Përsqopit. Kjo është pika e parë kyçe ku lexuesi njihet me atë që Petrela është dhe përfaqëson.

Në këtë çast, është momenti kur lexuesi nuk shkëputet më nga libri, por është kureshtar të dijë se çfarë risie dhe informacioni ka rezervuar autori më tej për lexuesin.

Element i veçantë që i jep një karakter shkencor dhe emotiv librit, është fakti që çdo e dhënë mbështetet në literaturë serioze shkencore dhe fakte historike. Këtij elementi i bashkohet në mënyrë harmonike ana shpirtërore e autorit, pasi është mjaft e lidhur me zonën ku ka lindur dhe jetuar. Nuk është e lehtë të ruhen balancat shkencore në një botim të tillë, për shkak të lidhjeve personale të autorit, por, në këtë rast, ka mbizotëruar ana shkencore. Autori është i vetëdijshëm, që vetë natyra e kësaj monografie është shkencore dhe, për pasojë, duhet të ruajë vlerat dhe kriteret që e klasifikojnë si të tillë. Gjatë gjithë trajtesës së këtij libri, imazhi që lexuesi përfytyron apo fantazon, është një ngjarje historike me personazhe të cilët jetojnë në një zonë gjeografike të përkryer, ku ndërthuren elementet natyrore dhe ato humane. Kodrat e buta të Petrelës, bimësia mesdhetare, klima e përshtatshme dhe njerëzit punëtorë janë tiparet e kësaj “ngjarjeje historike”. Koha nëpër të cilën kalon ky libër ndër shekuj e dekada, i japin ngjyrimin historik dhe kulturor që te lexuesi përcillet shumë natyrshëm.

Padyshim që ky botim do të jetë një vlerë e shtuar edhe për nxënësit dhe studentët e apasionuar pas historisë, fakteve dhe dëshmime historike. Rëndësinë e veçantë ky botim e merr dhe nga fakti që autori i tij, Adem Kupi, një vendas autokton nga Petrela, ka bërë që trajta e këtij libri të jetë mbresëlënëse. Puna e tij shumëvjeçare mbart dashuri, vlerë dhe shumë nostalgji për vendin ku u lind dhe u rrit. Objektiviteti i treguar dëshmon saktësinë dhe qartësinë e informacionit që përcillet në formë të përkryer shkencore dhe akademike.

Disa nga hulumtimet kryesore të renditura në këtë libër, kanë të bëjnë me albanologun e parë shqiptar, gjermano-austriak, Johan Georg Hahn, në vitin 1848. Ky studiues ishte shtysa që shumë albanologë shqiptarë apo historianë e arkeologë, si: Ceka, Frashëri, Baçe, Karaikaj etj., të vazhdonin kërkimet për rrënjët tona. Petrela, ndër etapa të caktuara historike, vijon të trajtohet si qendër e rëndësishme historike, duke u renditur edhe nga historianë të njohur, si Ana Komnena, apo autorë të tjerë bizantinë, si pikë kyçe në histori. Referencat e Marin Barletit, Fan S. Noli etj., për Kalanë e

Petrelës, vërtetojnë edhe njëherë për faktet e pashmangshme historike dhe seriozitetin e punës së autori të librit “Petrela gjatë shekujve”.

Veprimtaria dhe jeta sociale e kësaj qyteze asokohe, pas çlirimit, është një tjetër pikë e rëndësishme e këtij libri. Krijimi i fermave (kooperativave) dhe shumë ndryshime të karakterit social e kulturor janë të pasqyruara qartë në libër. Arsimi dhe kultura, kontribuuesit e parë në ngritjen e arsimit në Petrelë, janë të trajtuara hap pas hapi në libër. Një qasje e tillë lartëson figurat guximtare të asaj kohe, duke vendosur gurët e parë të themelit të shoqërisë shqiptare në drejtimin e arsimit.

Të gjitha këto qasje janë të bazuara në dëshmi konkrete historike, që do të thotë se dokumentet historike, botimet e albanologëve shqiptarë dhe të huaj, gjetjet arkeologjike etj., janë referencat kryesore për këtë botim. Ngjyrimet emotive që autori i jep veprës, e bëjnë më interesante dhe tërheqëse për lexuesin, duke e përfshirë në brendësi të ngjarjeve dhe duke fantazuar etapën historike.

Një libër që duhet të jetë i prekshëm nga të gjitha grupmoshat.